REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No. 01 / 568
DATE 13.05.25
PRISHTINË

KGJK.nr.147/2025
Datë: 8 maj 2025

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Rregulloren nr. 16/2024, për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimin e Marrëdhënies se Punës për Administrator të Gjykatave, në takimin e 346-të, të mbajtur me datë 8 maj 2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Kriteri i përvojës në pozita drejtuese si kusht formal për përzgjedhjen në pozitën administratorë në gjykata, hiqet.

II. Ndryshimi konform pikës I, të këtij vendimi, të reflektohet në aktet normative.

III. Obligohet Sekretariati i Këshillit Gjyqësor, për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Vendimi hyn në fuqi me datë 8 maj 2025.

A r s y e t i m

Proceset e fundit të rekrutimit për pozitën administratorë në gjykata, kanë rezultuar të pa suksesshme, e kjo ndër të tjera edhe për shkak të kritereve të përcaktuara në shpallje të pozitës, të cilat kanë ndikuar në ngushtimin e rrethit të kandidatëve të mundshëm.

Si rrjedhojë, nuk ka rezultuar në përzgjedhjen e kandidatëve të suksesshëm për pozitën administratorë dhe një numër i konsiderueshëm i këtyre pozitave në gjykata, vazhdojnë të mbulohen me ushtrues detyre.

Duke marrë parasysh situatën dhe nevojën për plotësimin e këtyre pozitave, Këshilli ka autorizuar Komisionin për Administrimin e Gjykatave që të hartoj një raport të detajuar lidhur me mënyrën e veprimit të mëtutjeshëm për çështjen e konkursit për administratorë të gjykatës.

Pas shqyrtimit të raportit dhe diskutimeve të zhvilluara brenda Këshillit, është vlerësuar se kriteri i përvojës në pozita drejtuese, ka rezultuar pengesë dhe se në praktikë përjashton kandidatë të kualifikuar që ndonëse nuk kanë mbajtur pozita drejtuese të formalizuara, posedojnë aftësi të mjaftueshme për të ushtruar detyrat për pozitën e shpallur.

Si përfundim, për të mundësuar proces të rekrutimit më gjithëpërfshirës, Këshilli ka vendosur që kriteri i përvojës në pozita drejtuese si kusht formal për përzgjedhjen në pozitën administratorë në gjykata, të hiqet, ndërsa kriteret tjera të mbesin të pa ndryshuara.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Departamentit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGjK;*
- *Sekretariatit të Këshillit; dhe*
- *Arkivit.*